VENDIM
Nr.298, datë 14.5.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.402, DATË 11.6.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DISA ÇËSHTJE NË ZBATIM TË LIGJEVE NR.7703, DATË 11.5.1993 "PËR SIGURIMET SHOQËRORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR DHE NR.7870, DATË 13.20.1994 "PËR SIGURIMET SHËNDETËSORE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të nenit 36 të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.402, datë 11.6.2001 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 5 e kapitullit I "Sigurimi i detyrueshëm" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"5. Të vetëpunësuarit në bujqësi, të aftë për punë, që kanë mbushur moshën 16 vjeç deri në moshën për pension sipas nenit 92 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, kur nuk janë të siguruar nga punësimi në sektorë të tjerë, kur banojnë në të njëjtin rreth ku kanë tokën në pronësi, të fituar nga ligji për tokën, dhe zhvillojnë veprimtari, bujqësore e blegtorale, sigurohen, në mënyrë të detyrueshme, për barrëlindjen, për pensione dhe për sigurim shëndetësor.".

2. Paragrafi i parë i pikës 6 të kapitullit III "Llojet, shuma dhe shpërndarja e kontributeve" ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Të vetëpunësuarit në bujqësi derdhin kontributin vjetor për sigurimet shoqërore në masën 7820 lekë, me përjashtim të rretheve Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë, për të cilat masa e kontributit vjetor është 5390 lekë.".

3. Paragrafi i shtatë i kapitullit V "Pagesa e kontributeve", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.5.2004.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano